
GJU ME GJU ME POPULLIN

The electronic version of the book is created by
http://www.enverhoxha.ru


GJU ME GJU ME POPULLIN

t

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORU»
TIRANË 1978



Albumi «Gju më gju me popullin» **kushtuar 70-vjetorit të lindjes së shokut Enver Hoxha nuk flet vetëm për jetën e veprën e udhëheqësit tonë të shtrenjtë, por edhe për jetën e veprën e një populli të tërë. Mes kësaj jete të madhe të popullit ndritin vitet e figurës së birit të dashur të tij, e themeluesit dhe udhëheqësit të Partisë dhe të shtetit socialist shqiptar. Duke shfletuar këtë album, ne shohim lindjen dhe rritjen e shoqërisë sonë të re, shohim fëmininë, rininë dhe pjekurinë tonë, shohim shkallët ku është ngjitur Shqipëria socialiste. Nëpër faqet e tij ndiejmë oshëtimën e Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, të përpjekjeve dhe të punës së madhe për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e Atdheut, ndiejmë marshimin tonë fitimtar në luftë të pashembullt me të gjithë armiqtë, imperialistë, revizionistë e reaksionarë, për të shpartalluar rrethimet dhe bllokadat, për ta ngritur lart e më lart nderin dhe lavdinë e Shqipërisë së re. Në këtë epokë të ndritur historike dora e çeliktë e Partisë e ka mbajtur kurdoherë të pastër flamurin e marksizëm-leninizmit.**



Në këtë shtëpi karakteristike gjirokastrite 70 vjet më parë, më 16 tetor 1908, lindi shoku Enver Hoxha.



«Sa shpresa dhe sa ëndrra kanë lindur në vitet e rinisë, përpara Çerçizit të bronztë!»

(Gjirokastër. Shoku Enver Hoxha, nga e majta lart, pranë monumentit).



«Dhe vajtëm në Shkodër. Së bashku me disa fshatarë zhveshëm palltot, përveshëm llërët dhe gërmuam tokën e Shtojit, nxorëm eshtrat e Çerçizit e të Muço Qullit».

(Shkodër, 1937).



Nga ky ballkon Shkodra dëgjoi për herë të parë zërin e Enver Hoxhës, zërin e djalërisë shqiptare, që betohej se do ta mbante të pashuar kujtimin e patriotëve dhe të luftëtarëve të lavdishëm e se do të bëhej shpresë për të ardhmen e Shqipërisë.




Midis rinisë korçare.

(1938)



Në Korçë më 1937.



«Do të luftojmë për një botë të re»

(Tablo e S. Shollës)



Dyqani «Flora» u bë vatër e komunistëve dhe çerdhe ëndrrash për të ardhmen.



«Shoku Enver në çetën e Pezës»

(Tablo e G. Madhit)



Në demonstratën antifashiste në Tiranë, 10 ditë para se të themelohej Partia Komuniste e Shqipërisë.



Themeluesi dhe udhëheqësi i PKSH.

(1941)



«U themelua Partia»

(Tablo e Sh. Hysës).





Konferenca e Pezës hodhi themelet e Frontit Nacionalçlirimtar e të Pushtetit Popullor.

(Shtëpia ku u mblodh Konlerenca e Pezës).

Miqësi partizane

(Me Babë Myslimin. Labinot 1943)



Midis partizanëve dhe fshatarëve

(Polii i Librazhdit. korrik 1943)




Krah për krah tij atyre u rritej besimi në fitore

(Me Vasil Shanton më 1943)



«10 Korrik 1943. Formimi i Shtabit të Përgjithshëm».

(Tablo e G. Madhit)



Gusht 1943.



Kush luftoi në suferinë
Enveri me vegjëlinë

Me partizanët e Brigadës I S. gusht 1943



Na puthi ne, fëmijët, mu në ballë
Dhe pa në sytë tanë vetëtima,
Dhe pa ata që ngrenë sot turbina.

(Në zonën e Çermenikës, 1943)



Në Shëngjergj të Tiranës në inaugurimin e Brigadës II S.

(28 Nëntor 1943)



Në prag të Konferencës I të Vendit të PKSH



Me Spiro Moisiun në rrethin e Elbasanit.



Shoku Enver gjatë Operacionit armik të Dimrit

(1943-1944)



«Çajmë rrethime»

(Jablo e F.Haxhiut)



Gjatë mësymjes pranverore të vitit 1944



Një kujtim i paharruar për vajzën e vogël çermenikase me shokun Enver Hoxha dhe dr. Medar Shtyllën.



Në mes kuadrove të kursit të Partisë për edukimin marksist-
-leninist në Panarit, 1944.



Me partizanët që ishin ngarkuar për sigurimin e Shtabit të Përgjithshëm, 1944.



Drejt Kongresit të Përmetit.



Duke shkuar në sallën e Kongresit të Përmetit.



Përmeti rrëzë Dhëmbelit
Dëgjon fjalën e Enverit

Në Kongresin e Përmetit (Maj 1944)



Në ditët e Kongresit të Përmetit.



Kongresi i Përmetit themeloi shtetin shqiptar të demokracisë popullore.

Midii shokëve dhe bashkëluftëtarëve të tij të ngushtë, Përmet 1944.



...Nga lufta vijmë, në luftë shkojmë...



Plani i çlirimit të plotë të Shqipërisë u hartua në shpatullat e maleve të përvëluara nga baruti.


(1944)



Rinia jonë nuk do ta harrojë kurrë Helmësin, kur mes delegatëve të Kongresit të saj të Parë kaloi udhëheqësi dhe mësuesi i saj i dashur.



Në ditët e Kongresit të Parë të Rinisë në Helmës, shoku Enver bisedon me Nako Spirun.



Ata që ishin në atë kongres dhe mijëra të tjerë që ishin në male e mbajtën në zemër fjalën e mësuesit të tyre të dashur nëpër shtigjet e luftës dhe të lirisë, siç mbanin fishekët në vezmet...

Shoku Enver flet në Kongresin e Rinisë në Helmës



Edhe një kujtim tjetër nga Helmësi, ku u mbajt Kongresi i Rinisë.



Sa përleshje me fashistët, nazistët dhe tradhtarët, sa tortura e gjak mes shiut, dëborës, vapës dhe urisë, sa shokë të mbetur maleve në lulen e rinisë donte rruga që na shpuri gjer në Berat!



Shoku Enver flet në Mbledhjen e Beratit, ku u formua Qeveria Demokratike Popullore me ministra partizanë, që mbanin rroba e çanta të shpuara nga plumbat.

(1944)



Në Berat. 1944




Në Odriçan

(1944)



Orët e lirisë po afrohen.




Në Tiranën e çliruar

(17 Nëntor 1944)



Agimet e Nëntorit.



Në luftën e përgjakshme rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi kundër një armiku të vendosur e të egër, të armatosur me mjete më moderne, vullneti i hekurt i ushtrisë dhe i popullit të Tiranës triumfoi

(Nëntor 1944)



Parakalojnë fitimtarët

(Tiranë, 28 Nëntor 1944)



Në vitin e parë të lirisë.



Kongresi II i Rinisë

(16 prill 1945)



Në përvjetorin e parë të Ushtrisë sonë Popullore, të asaj ushtrie që do të mbante ngaherë të ndezur zjarrin partizan.

(10 Korrik 1945)



Kongresi I i Frontit Demokratik të Shqipërisë

(Gutht 1945)



Kongresi I i Sindikatave

(Tetor 1945)



«Toka është jotja, të takon ty që e punon.»



Duke folur në Asamblenë Kushtetuese

(11 Janar 1946)



Kongresi II i Gruas

(30 qershor 1946)



«Populli shqiptar nuk e ka dërguar delegacionin e tij në Paris për të dhënë llogari, por për t'u kërkuar llogari atyre që e kanë dëmtuar aq tepër dhe që ai i ka luftuar me ashpërsi gjer në fund».

Konlerenca e Paqes në Paris, shlator 1946.



Takim me Gjergj Dimitrovin

(Bullgari 1947)



- Ta mbani këtë pushkë përherë të gatshme për mbrojtjen e Atdheut tonë të shtrenjtë...

(10 Korrik 1946)



Hekurudhat tona të para të rinisë, që nesër do t'i zgjatin krahët e hekurt mespërmes maleve të larta.

Fillimi i punimeve të hekurudhës së parë në Shqipëri, 1 Maj 1947.



Armata e madhe e luftëtarëve të rinj të socializmit para Komandantit të tyre të dashur.



Biri i popullit me popullin

(Drashovicë, korrik 1947)



Në krahët e njeriut më të shtrenjtë

(Kuç, korrik 1947)



Do këndoj do heq një valle
për Partinë famëmadhe.



Mirë se erdhe, o bir!



Në sheshin e Çerçizit, kur liria ende s'kishte mbushur tre vjet nga dita e saj e lindjes.



Edhe një hekurudhë e re në hartën e Republikës.

Inaugunmi i hekurudhës Tiranë-Durrës, 23 shkurt 1949

Kongresi I i Partisë Komuniste të Shqipërisë plotësoi kthesën historike në jetën e Partisë dhe të të gjithë vendit, vuri Partinë me vendosmëri në rrugën e marksizëm-leninizmit, dha orientimet themelore për ndërtimin e bazave të socializmit.



Nga salla e Kongresit I të PKSH



8 Nëntor 1948. Shoku Enver Hoxha mban raportin mbi punën e Komitetit Qendror në Kongresin I të PKSH.




«...çështja e kolektivizimit... është e ardhshmja jonë e ndritur në fshat, ... është rruga e socializmit».

Në Kongiesin e Parë të Kooperativave Bujqësore, shkurt 1949



Nderim Leninit të madh!

Vizita në Mosfcë në «Mauzoleumin Lenin» (Prill 1949)



Dhe Shqipëria gjëmonte: Me ty Stalin, me ty Enver!



Konferenca e Parë Nacionale e Sulmuesve dhe e Novatorëve.

(Mars 1951)



Shqipëria ecën e patundur drejt diturisë, rrugën ia ndriti Partia.

Në inaugurimin e instituteve të larta, 20 nëntor 1951



Lulja e parë e hidrocentraleve, shiriti i parë i veprave të dritës...

Inaugurimi i hidrocentralit «Lenin», 27 nëntor 1951



Këtej e filluam betejën mbi lumin Mat.

Inaugurimi i punimeve për ndërtimin e hidrocentralit mbi lumin Mat, janar 1952

Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë përcaktoi orientimet për shndërrimin e Shqipërisë në një vend bujqësor-industrial.



Nga salla e Kongresit II të PPSH



31 mars 1952. Shoku Enver Hoxha mban raportin e Komitetit Qendror në Kongresin II të PPSH.




Në Kongresin II të PPSH me shokun Mehmet Shehu



Vizitë në Burrel

(Shtator 1952)





«S'ka kënaqësi më të madhe për mua dhe shokët e mi se gëzimi që ndiejmë kur ndodhemi në mes të popullit, kur takohemi me njerëzit nga viset më të largëta të Atdheut, kur bisedojmë me ta gojarisht.»

(Burrel, shtator 1952)



...dhe këtu do të bëhet një liqen i bukur...

Në punimet e Rrugës së Dritës, 1952



Për lulëzimin e artit tonë kinematografik

Inaugurimi i Kinostudios, korrik 1952.





Betimi përpara Stalinit

(9 mars 1953)

Kongresi III i PPSH mbrojti politikën revolucionare të Partisë dhe në frymën e kësaj politike përcaktoi detyra të reja për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, duke nxjerrë në plan të parë detyrën për të përfunduar kolektivizimin e bujqësisë.



Nga salla e Kongresit III të PPSH



25 maj 1956. Shoku Enver Hoxha mban raportin e Komitetit Qendror në Kongresin III të PPSH.



Ëndrra e rilindasve të mëdhenj, Abdylit, Naimit dhe Samiut me shokë, që Shqipëria të kishte universitetin e saj, u bë realitet në epokën e Partisë.

Inaugurimi i universitetit, shtator 1957



«Marshimi» i hidrocentraleve...

Inaugurimi i hidrocentralit «Karl Marks», janar 1958



Midis kooperativistëve.

(Berat, tetor 1958)



Moçaleve të Vurgut u dhanë fund përgjithmone...

Inaugurimi i kanalit të Çukës, qershor 1959

Kongresi IV i PPSH hyri në histori si kongresi që çeli një etapë të re të zhvillimit të vendit, etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, përgatiti Partinë për një sulm të përgjithshëm kundër revizionizmit modern.



Nga salla e Kongresit IV të PPSH.



23 shkurt 1961. Shoku Enver Hoxha mban raportin e Komitetit Qendror në Kongresin IV të PPSH.



Vlorë 1962.



Në mes atyre që luftuan tok me Ismail Qemalin, Selam Musanë e Bajram Currin.

Në 50-vjetorin e Pavarësisë, Vlorë, 1962.



Në gjimnazin «Qemal Stafa»
(1965)



Fjala e 6 shkurtit 1967 ishte një flakë e madhe, që ndezi gjithë zemrat e mendjet e popullit tonë.

f

Kongresi V i PPSH përcaktoi detyrat për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë e të jetës së vendit, për zhvillimin e thellimin e revolucionit socialist në të gjitha fushat si dhe për luftën kundër frontit të bashkuar imperialisto-revizionist.



Nga salla e Kongresit V të PPSH.



1 nëntor 1966. Shoku Enver Hoxha mban raportin e Komitetit Qendror në Kongresin V të PPSH.



I duam tribunat e Majit të kuq! Në lartësitë e tyre na përshëndet e na buzëqesh Enveri...



Me ty tërë jetën! Këto shami të kuqe janë zemrat tona.

(Qershor 1967)



Në kooperativën bujqësore të Laknasit.

(Tiranë, qershor 1967)



Krah për krah me Babë Myslimin, ku një çerek shekulli më parë u mbajt Konferenca historike e Pezës.



«...do t'i vëmë Drinit një gjerdan me dritë...» u tha luanëve të rinj të tuneleve dhe mjeshtërve të digave të lumenjve.

(Në Vaun e Dejës, shtator 1967)



E sotmja e gruas është e bukur, e nesërmja do të jetë më e bukur!

(Lezhë, Troshan, shtator 1967)



Ju, baballarët tanë, keni djem të mirë!

Vizitë në rrethin c Shkodrës shtator, 1967



Birit të tyre ata i thanë: «Shqiptarin nuk e ka nxjerrë lokja prej barkut por huta prej çarkut».



Kutinë e duhanit të fortë ia vë përpara: «Ndize, bre burrë!»

Vizit**ë **nc rrethin e Shkodrës, shtator, 1967



Dikur në këtë shkollë ai vetë ka dhënë mësim dhe ka ndezur zjarrin e parë të komunizmit në zemrat e rinisë korçare.

Shoku Enver merr pjesë në jubileun e 50-vjetorit të shkollës «Raqi Qirinxhi», nëntor, 1967.



Yllka, ju jeni vetë e ardhmja!



- Pa të dëgjojmë si përgjigjet shoku juaj!»

(Korçë, nëntor 1967)



Në rrugicat e lagjes ku u themelua Partia.

(Tiranë, nëntor 1967)



Strehëz,
Moj strehëz,
Ti ishe selia e parë e Komitetit Qendror të Partisë,
Ti ishe selia e parë e Këshillit të Ministrave,
Ku hynin të gjitha ministritë:
Që nga e Mbrojtjes gjer te e Industrisë
Nën zhurmën e plumbave
Dhe erën e shkrumbit të drithërave...



Sa ngjyra, sa buzëqeshje,
Sa njerëz, aq gëzime!
Në Kongresin VI të BGSH

(Nëntor, 1967)



Në ato ditë të tërmetit në Dibër e Librazhd.

(Dhjetor, 1967)




Duke përgëzuar kufitarin Mehmet Elezi, që shkon për të zëvendësuar vëllanë e tij Agronin, vrarë në krye të detyrës.
(Posta kufitare e Bllatës-Dibër, 1967)



Nderim në shekuj Skënderbeut, kryetrimit legjendar!

Miling në Krujë, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, janar, 1968)



Në gjurmët e Komandantit, në gjurmët e brigadave partizane.



Rini, ta mbash ngaherë
pranë librit e kazmës edhe pushkën!

Kongresi V i BRPSH, qershor, 1968



Takim i paharruar në Shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme.



Në trenin që kaloi në hekurudhën e porsainauguruar.





«Revolucioni tekniko-shkencor është pjesë përbërëse e revolucionit tonë socialist dhe zhvillohet në unitet me revolucionin ideologjik e kulturor»
Aktivi kombëtar për kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor.

(Tiranë, shkurt 1969)



Me gurskalitësit e vegjël.

(Berat, shkurt 1969)



Në Ninësh të Mallakastrës në ditët e tërmetit, prill 1969



25-vjetori i Kongresit të Përmetit.
(Përmet, maj 1969)



Gëzuar festën, vëllezër e motra!



«...Zemra e Partisë është një zemër shumë më e madhe se zemra e një nëne të vetme, ajo është një zemër bujare, që kujdeset për të gjithë popullin».

Shtëpia e fëmijës «8 Nëntori» Tiranë, nëntor, 1969




Në Shqipërinë socialiste s'ka jetimë,
Se ngroh kudo dashuria e Partisë!



«Nënë, Mihali yt është i gjallë ndër të gjallët»

Nga ceremonia e dekorimit të Mihal Durit «Hero i Popullit» nëntor 1969




Në Vaun e Dejës

(1970)



Me sharrëxhinjtë e Pukës

(Pukë, 1970)



E dimë, ke punë e halle,
Ata andej matanë detit e malit çoç flasin,
Niksonë, Fordë, Brezhnjevë e ç'janë...
Ama sikur pak të na ngasin,
Flakë merr stralli e flakë e bëjmë dynjanë!
(Tropojë, maj 1970)



Duke nderuar kujtimin e Plakut të Maleve Bajram Curri.

(Tropojë, maj 1970)



N'maj të bjeshkës vlon kuvendi,
Hesht Valbona e këndon Shkëlzeni,
Ngrihet në kambë e gjithë malësia
Pret Enverin Dragobia...

(Tropojë, maj 1970)



Majat e Dragobisë.



Kush po i ngjitet Dragobisë?
Themeluesi i Partisë,
Gju më gju me tropojanë
Bajram Currit po i lëshon zanë.

(Tropojë, mai 1970)


K. MARKS
KAPITALI
ENVER HOXHA
MBI DIKTATURËN E PROLETARIATIT
ENVER HOXHA
MBI LETËRSINË
ENVER HOXHA
RAPORTE E FJA
1965 - 1966
ENVER HOXHA
ENVER HOXHA
SELECTED WORKS
ENVER HOXHA
Der Kampf der Partei der Arbeit Albaniens gegen den
ENVER HOXHA
NË NDIHMË
ENVER HOXHA
ENVER HOXHA
RAPORTE E FJALIMEVE
ЭНВЕР ХОДЖА
АПТ В БОРЬБЕ ПРОТИВ ХРУЩЕВСКОГО РЕВИЗИОНИЗМА
انور خوجا
ENVER HOXHA
DISKUTIME
RAPORT
ENVER HOXHA
LA CRISI DEL REVISIONISMO MODERNO ITALIANO
Enver Hoxha
Albania frente a los revisionistas jruschovistas
1960



«Të mësojmë teorinë marksiste-leniniste në lidhje të ngushtë me praktikën revolucionare»

Në 25-vjetorin e themelimit të Shkollës së Lartë të Partisë «V.I.Lenin»
8 Nëntor 1970



«Ju keni duar të florinjta. Këtë qelq e bëni të këndojë!»

Me punëtorët e qelqit në Kavaië, prill 1971



Ai tani është thinjur, por ato i thonë bir dhe ai u thotë nëna. Sa të dashura janë këto nëna!

Me pjesëtarë të familjeve që ishin baza të Luitës Nacionalçlirimtare.

prill, 1971

Kongresi VI i PPSH shtroi si pikësynim kryesor thellimin e revolucionit socialist në të gjitha fushat dhe fuqizimin e përgjithshëm të ekonomisë popullore në rrugën e kthimit të Shqipërisë socialiste nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrial-bujqësor. Ai orientoi Partinë për të vazhduar me vendosmëri, guxim e largpamje luftën kundër gjithë armiqve të komunizmit, me imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë në krye, kundër çdo vështirësie e pengese për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.



Nga salla e Kongresit VI të PPSH.



8 Nëntor 1971. Shoku Enver Hoxha mban raportin e Komitetit Qendror në Kongresin VI të PPSH.



Shqiponjave të qiellit të pastër shqiptar ky shtrëngim duarsh ua rrit lartësinë e fluturimeve dhe zemrave u jep krahë.

Takim me pilotël, dhjetor, 1971



Sa më të forta, të çelikta të jenë radhët tona, aq më i fortë dhe i paprekshëm bëhet Atdheu.

(Çorovodë, 28-29 nëntor 1972)



«Socializmin e ndërtojnë masat, Partia i bën ato të ndërgjegjshme»

Midis anëtarëve të plenumit të Komitetit të Partisë të rrethit të Matit, shkurt 1972



«Sa herë që Partia ka shtruar detyra dhe ka çeiur perspektiva të reja për ndërtimin e socializmit, fjala e klasës punëtore, mendimi dhe vepra e saj kanë qenë gjithnjë vendimtare për realizimin e tyre».

Përshëndetje në Kongretin VII të BPSH, 8 maj 1972




Vlorë, nëntor 1972.



Ta ngremë lart flamurin e Ismail Qemalit...

(Vlorë. nëntor 1972)



Kombinati metalurgjik, Elbasan.





Në Kombinatin metalurgjik.

(Elbasan, maj 1973)



Një këngë me çitteli për ujin e kristaltë që gurgulloi në çezmat e Koplikut.

Në inaugurimin e ujësjellësit të ri në Koplik, qershor, 1973



«Veteranët tanë janë përfaqësimi i gjallë i heroizmit partizan, i devotshmërisë së pafund ndaj çështjes së lirisë e të pavarësisë, të revolucionit tonë popullor».

Nga mesazhi drejtuar Konlerencës III të Veteranëve, mars, 1974



Ata i thanë shokut Enver: «Do të punojmë, do të luftojmë dhe do të jetojmë si në rrethim».

Në Uzinën «Traktori» prill, 1974



Me punëtorët e Uzinës «Traktori».

(Tiranë, prill 1974)



Për lumturinë e popullit.

Votimet për deputetët e Kuvendit Popullor, Tiranë, tetor 1974



Takim me zgjedhësit.

(Tiranë, 3 tetor 1974)



Duke vizituar ekspozitën «Shqipëria sot»

(Tiranë, 1975)



Pamje nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës.

(Maj, 1978)




Nga themelimi i Akademisë së Shkencave

(Janar, 1973)



Me mësimet e Partisë e të shokut Enver u rrit një armatë e madhe artistësh, që janë ndihmës të Partisë në edukimin komunist të njerëzve tanë.

Takim me artistët, Tiranë, nëntor 1975



Giza e parë shqiptare.



Mbi gizën e parë të markës shqiptare ne skalitëm fjalën: «P A R T I».

(Prill. 1976)



Lavdi atyre që ranë për Atdheun, për lirinë e socializmin.


(Tiranë, 5 maj 1976)



Kongresi VII i PPSH shprehu vendosmërinë e patundur të saj për të zbatuar, si kurdoherë, me besnikëri marksizëm-leninizmin dhe për ta mbrojtur atë nga çdo shtrembërim e goditje, për ta udhëhequr popullin shqiptar në rrugën e revolucionit socialist. Krahas teorive dhe praktikave antimarksiste të revizionizmit sovjetik, jugosllav etj., ai demaskoi edhe teorinë kundërrevolucionare të revizionizmit kinez «mbi tri botët». Kongresi e përgatiti Partinë e popullin shqiptar për të përballuar çdo situatë në ndërtimin socialist dhe në mbrojtjen e Atdheut mbështetur në forcat e veta.



Nga salla e Kongresit VII të PPSH.



1 Nëntor 1976. Shoku Enver Hoxha mban raportin e Komitetit Qendror në Kongresin VII të PPSH.



Të rrojë Partia!

Kongresi VII i PPSH, 1 nëntor 1976



Në Shtëpinë e Partisë.

(Nëntor, 1976)



Na pri Parti, na pri Enver!

Kongresi VII i PPSH, 1 nëntor 1976



Internacionale
do të jetë bota e re!

Midis delegacioneve të partive marksiste-leniniste që morën pjesë në Kongresin VII të PPSH.



Miratimi i Kushtetutës së Re të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë.

(28 dhjetor 1976)



«Kushtetuta e re përshkohet tërësisht nga ideologjia e parimet themelore të marksizëm-leninizmit, mishëron mësimet dhe përvojën revolucionare të Partisë sonë të Punës dhe mban vulën e mendimit krijues të masave të gjera të popullit tonë».




«Rinia e vendit tonë ka qenë dhe mbetet forcë e gjallë e revolucionit dhe e ndërtimit socialist. Ajo kurdoherë është treguar patriote, e zjarrtë, luftëtare besnike për çështjen e Partisë dhe mbrojtësja e flaktë e vijës së saj marksiste-leniniste».

Kongresi VII i BRPSH, Elbasan, shtator 1977.



Në Kongresin VII të BRPSH.





Do të rrjedhin ditët dhe vitet. Ata do të rriten dhe do të shpërndahen si zogjtë nëpër gjithë Republikën por nuk do ta harrojnë kurrë atë fund dhjetori të vitit 1977 kur festuan Vitin e Ri bashkë me xhaxhi Enverin.



Vizita në Gjirokastër.


(Mars, 1978)



Buçet sheshi i Çerçizit:
- Na ka marrë malli, Enver!
— Edhe mua!



Ju jeni të pavdekshme, motra!



«Dy mijë shkallë ka nga këmbët deri te koka e saj, gur f tëri. Shumë e dashur dhe shumë e shtrenjtë për të gjithë ne.»

Duke parë Gjirokastrën nga kalaja (Mars, 1978)



«Çfarë kalaje! Hajde zaptoje po deshe! - këtë s'e kanë bërë të pamposhtur muret, por njerëzit».



Kështu të paçim ngahera, të fortë e të ri!



«Nuk duhef ta largojmë kurrë vëmendjen, jo vetëm nga lufta që duhet bërë kundër imperializmit amerikan dhe gjithë borgjezisë reaksionare kapitaliste botërore, por edhe kundër revizionizmit sovjetik, revizionizmit jugosllav, revizionizmit aktual kinez, etj.».

Nga takimi me kuadrot e rrethit të Gjirokastrës, mars, 1978





Mashkullorë.

(Mars, 1978)



Nderim Çerçizit dhe çetës së tij trime, që luftuan te rrapi në Mashkullorë!



Pamja nga mitingu me dropullitët, në kooperativën bujqësore të tipit të lartë të Grapshit.

(Mars, 1978)



«Dropullitet, minoriteti grek e populli shqiptar dhe, veçanërisht, populli i Gjirokastrës kanë qenë të lidhur ngushtë si mishi me thoin, janë dashur si motra e si vëllezër».




- Në festivalin që do të bëhet në tetor do të dalim me dasmën gjirokastrite, - thotë Xhevati.
- Mos harroni edhe magjen me brumë! - i përgjigjet shoku Enver.



- Po ku je, more Malo! Kam pyetur aq herë për ty. Do të vija nga furra.
— Hajde në shtëpi, shoku Enver.



- Hajde ti, Sokrat Kutra. Ti je më i moshuar nga ne. Pa na jep pak mësim!



- A ia marrim njëherë, mo Xhevat?
Lumi Vlorësë të vijë,
Ç'u shkulën që në Radhimë,
Kaptuan Shavasinë,
Ranë pellgut në Delvinë,
Mbi Sulo Kallapodhinë!



- Gëzohem shumë që ju shoh të lumtur e të gëzuar!
- Të gëzuar na bëri Partia!

(Sarandë, Mars, 1978)



Shokë, mbamëni në valle,
Jam fatos i vogël fare,
Në këtë tribunë të madhe
Xhaxhi Enverin të urojmë:
Sa malet tona të rrojë!



- «Kultura jonë ka specifikën e vet dhe zë një vend të nderuar në kulturat e lashta të popujve».





Lukovë, 1978




- Nuk ngopem duke e parë këtë vend!



«Gratë e vendit tonë kanë treguar kurdoherë me vepra të shumta dashurinë e madhe dhe devocionin e pakufishëm që kanë për Partinë, sepse te Partia ato panë udhëheqësen e vërtetë që do të realizonte ëndrrën e madhe të tyre, që do t'i bënte të lira e të barabarta, të nderuara e të respektuara në shoqëri».


Në Kongresin VIII të BGSH, Durrës, qershor 1978




Partia e ngriti lart nderin e rilindasve të mëdhenj, e atyre që janë lavdia e Atdheut tonë.



«Të tillë njerëz ka nxjerrë Shqipëria! Pra, të gjithë këtë traditë të madhe të historisë së popullit tonë ta ruajmë të pastër».





Abdylit, Naimit, Samiut - përjetë nder e lavdi!



Në 35-vjetorin e themelimit të Ushtrisë sonë Popullore, mbrojtëse besnike e Atdheut dhe e fitoreve të revolucionit.

(Korrik, 1978)



Duke kaluor në revistë studentët e kuadrot e shkollave ushtarake me rastin e 35-vjetorit të themelimit të Ushtrisë sonë Popullore.

(Tiranë, korrik 1978)



«Kohërat janë të tilla që liria dhe pavarësia e popullit dhe sovraniteti kombëtar të fituara me luftë, mund të ruhen dhe të mbrohen duke pasur në këmbë një ushtri të shëndoshë, të disiplinuar, të brumosur me ndjenjat proletare dhe me një besnikëri të pafund ndaj popullit dhe Atdheut socialist»

(Korrik, 1978)



Korrik, 1978




Një kujtim të shtrenjtë me themeluesin dhe Komandantin e Përgjithshëm të Ushtrisë sonë Popullore.

(Korrik. 1978)



Në Drilon.



Miting i kryeqytetit me rastin e mbylljes me sukses të plotë të punimeve të Kongresit VII të PPSH.



Të rrojë populli, të rrojë Partia!
Lavdi marksizëm-leninizmit!

SHTYPUR NË KOMBINATIN POLIGRAFIK «SHTYPSHKRONJA E RE»
T i r a n ë , 1978